



Challenge Education Group
Shkolla Franko-Shqiptare "Ernest Koliqi"
www.ernestkoliqi.com

RREGULLORE E BRENDSHME E NXENESIT

Prania në shkollë

Nxënësi paraqitet në shkollë në orën 7:30 -7:50 të mëngjesit. Ai shkon në klasën ku do të zhvillojë mësim duke respektuar gjatë lëvizjes distancimin fizik dhe udhëzuesin për situatën COVID -19.

Nxënësi qëndron në shkollë deri në orarin e përcaktuar (mësim, studim, konsultim) që është ora 14³⁰ paraprakisht në marrëveshje me prindërit.

Nxënësi nuk mund të largohet nga shkolla brenda orarit mësimor, përveçse me kërkesën e njërit prej prindërve dhe me miratimin e drejtuesit të shkollës (në raste të veçanta).

Nxënësit që vijnë në shkollë me mjetet e transportit të shkollës, nuk mund të ndalojnë, zbresin apo largohen nga automjeti i shkollës për asnjë arsye, përveçse në rast rrezikimi të sigurisë personale. Largimi nga automjeti i shkollës nuk mund të autorizohet as nga mësues që mund të ndodhen në këtë automjet dhe rrjedhimisht, nëse jepet ky autorizim, është i pavlefshëm. Në këto raste do të komunikohet menjëherë me prindin.

Në mëngjes nxënësi duhet të paraqitet në kohën dhe vendin e caktuar për t'u marrë nga automjeti i shkollës. Vonesa për më tepër se 3 minuta, sjell largimin e automjetit dhe në këtë rast, shoqërimi në shkollë është përgjegjësi e prindërve dhe nxënësi do të marrë mungesë pa arsye.

Nxënësit që vijnë në shkollë vetë, pra jo me automjetet e shkollës, duhet të respektojnë oraret e mësipërme. Nxënësit nuk mund të hyjnë në klasë pasi ka filluar ora e mësimi.

Gjatë lëvizjes jashtë shkollës (ekskursione, veprimtari të ndryshme), ku pjesëmarrja e nxënësit do të jetë vetëm me miratimin e prindit, nxënësi nuk mund të largohet nga automjeti pa autorizimin e drejtuesve të shkollës. Gjithashtu nxënësi nuk mund të largohet nga grupi i nxënësve ose vendi i përcaktuar për të qëndruar, pa autorizim të drejtuesve të aktivitetit.

Në rastin e lëvizjeve për qëllime mësimore, pjesëmarrja e nxënësve është e detyrueshme duke respektuar të gjitha rregullat e lartpërmenduar.

Çdo nxënës duhet të takohet në mënyrë periodike me psikologun e shkollës sipas një orari të caktuar prej saj. Biseda shërben për të ndjekur ecurinë e nxënësit në shkollë dhe për të parë nëse shkolla mund të ndihmojë apo bëjë më tepër për një mjedis sa më të mirë për nxënësit.

Nxënësit duhet të respektojnë udhëzimet e stafit të sigurisë së shkollës.

Komunikimi

Nxënësi duhet të respektojë si të barabartë me veten të gjithë nxënësit e tjerë. Askush nuk mund të diskriminohet, fyhet, apo dhunohet fizikisht apo me fjalë. Nxënësi duhet të tregojë respekt ndaj mësuesve dhe stafit të shkollës në përgjithësi. Respekti tregohet përmes komunikimit të kulturuar dhe mirësjelljes.

Nxënësi duhet të shmangë fjalorin fyes, apo banal në përgjithësi, pavarësisht se ndaj kujt drejtohet. Gjatë qëndrimit brenda ndërtesës së shkollës, nxënësi duhet të shmangë përdorimin e zërit të lartë për të mos shqetësuar nxënësit e tjerë, që mund të jenë duke studiuar apo edhe stafin.

Nxënësit nuk duhet të përfshihen në grindje fizike dhe verbale. Ata duhet të lajmërojnë menjëherë stafin e shkollës për çdo shqetësim ndaj tyre apo ndaj të tjerëve, në mënyrë që të parandalohen problemet.

NDALOHET RREPTESISHT PËRDORIMI I CELULAREVE APO MJETEVE TE TJERA TE KOMUNIKIMIT NE KLASE! Mund të përdoren vetëm pajisje elektronike të lejuara nga mësuesi (p.sh. laptop). Në rast se nxënësi thyen rregullin e përcaktuar më sipër, atij i merret celulari dhe i sekuestrohet në Drejtori, deri në fund të vitit shkollor; më pas ai i dorëzohet vetëm prindit.

Veshja

Nxënësit do të përdorin uniformat e shkollës sipas udhëzimit të drejtorisë. Uniformat përfshijnë veshje për pjesën e sipërme të trupit. Për pjesën e poshtme, nxënësit duhet të veshin pantallona xhinse të gjata me ngjyrë të errët dhe të rregullta.

Nxënësit nuk mund të përdorin aksesore ekstravagantë që tërheqin vëmendjen. Nxënësit duhet të vijnë në shkollë me çanta të përshtatshme për shkollë. Gjithashtu nxënëset nuk duhet të përdorin makiazh. Nxënësit që nuk do të respektojnë këto parime, nuk do të lejohen në mësim dhe do të qëndrojnë në bibliotekë, ndërkohë që për shkeljen do të njoftohen edhe prindërit.

Nxënësit të cilët nuk respektojnë rregulloren e shkollës në lidhje me ardhjen në shkollë me uniformë, hyrjen në orar në mësim, mirëmbajtjen e bazës materiale etj, do të penalizohen me sanksion financiar në vlerën 500 lekë. Në rast të përsëritjes ky sanksion dyfishohet.

Për shkeljen e bërë njoftohet prindi dhe mësuesja kujdestare mban shënime të rregullta në dosjen e klasës në kujdestari. Në fund të vitit shkollor shkolla nuk e pajis nxënësin me deftesë apo çdo dokument tjetër, pa u bërë shlyerja e detyrimeve financiare të krijuara nga sanksionet.

Konsumi i pijeve dhe ushqimeve

Nxënësit janë të lirë të përdorin të gjithë ushqimet apo pijet që autorizon shkolla në mjediset e saj. Këto pije dhe ushqime autorizohen nga drejtuesit e shkollës, pasi sigurohet se janë të shëndetshme. Nxënësit janë të lirë të konsumojnë ushqime dhe pije të përgatitura në shtëpi nga prindërit, duke përjashtuar këtu

çdo lloj pijeje alkoolike. Nuk lejohet në asnjë mënyrë që, gjatë qëndrimit në shkollë, nxënësit të marrin ushqime të porositura nga jashtë dhe të pakontrolluara.

KONSUMIMI I PIJEVE NUK LEJOHET NË KLASË!

Gjatë kohës së ngrënies do të respektohet me rigorozitet orari prej 30’.

NDALOHET RREPTESISHT DHE NDËSHKOHET MAKSIMALISHT PERDORIMI I DUHANIT DHE I ÇFAREDO PIJEJE ALKOOLIKE PAVARESISHT SE NGA VJEN!

Përdorimi i pajisjeve dhe mjedisit të shkollës

Shkolla i ka gjithmonë dyert e hapura për nxënësit. Nxënësit kanë në dispozicion të plotë gjatë të gjithë orarit të gjithë pajisjet e shkollës, sipas planifikimit mësimor. Nxënësit mund të përdorin gjithashtu edhe mjediset e tjera të shkollës (klasat, bibliotekën , palestrën, fushën e kalçetos, amfiteatrin, etj), mbas orarit mësimor, pra në oraret e lira.

Gjatë kohës së përdorimit të mjediseve dhe pajisjeve të shkollës, nxënësit duhet të kujdesen për mirëmbajtjen dhe mosdëmtimin e tyre. Dëmtimi i qëllimshëm i mjediseve, apo pajisjeve detyron nxënësin të dëmshpërblejë shkollën në vlerën e blerjes së pajisjes së dëmtuar, natyrisht duke njoftuar prindërit.

Kopjimi dhe plagjiatura¹

“Ernest Koliqi” nxit ndershmërinë shkollore. Kopjimi dhe plagjiatura ndalohen rreptësisht. Në rast konstatimi kopjimi në teste apo detyra të ndryshme, ndëshkohen me notë negative, si për nxënësin që ka kopjuar dhe për atë që ofron kopjen. Ndërsa në rast plagjature, punimet e nxënësve nuk do të pranohen dhe do të vlerësohen përsëri negativisht.

Sanksionet

Shkeljet e rregullave të mësipërme sjellin si pasojë edhe sanksione, që fillojnë me qortim, vërejtje individuale, paralajmërim me përjashtim nga shkolla dhe në rastet më të rënda edhe përjashtim nga shkolla, duke ju referuar dhe Dispozitave Normative në fuqi. Në të gjithë rastet, për çdo shkelje lajmërohet edhe prindi.

¹ Plagjiatura nënkupton paraqitjen e një teksti apo materiali të një autori të caktuar si punim original i vetë nxënësit, qoftë në tërësi, qoftë i marrë pjesërisht. P.sh. kur disa paragrafe të një teksti merren nga Interneti, përfshihen në një ese dhe paraqiten si punim i vetë nxënësit.